



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 764/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Afijete Safa - Glllogjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Faton Xhaqkaj, duke vendosur lidhur me apelin e Lirije Kajtazi, kandidate për deputete nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, i paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet e apeluara, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.03.2021, mori këtë

## V E N D I M

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.764/2021 i datës 05.03.2021, i ushtruar nga Lirije Kajtazi, kandidate për deputete nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, i paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet 2050A/02D, 2014A/02D, 2002A/03R, 0401D/17R, 0443D/01D.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 05.03.2021, ka pranuar apelin Anr.764/2021 nga Lirije Kajtazi, kandidate për deputete nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me të cilën pretendon se ka pasur parregullsi në vendvotimet 2050A/02D, 2014A/02D, 2002A/03R, 0401D/17R, 0443D/01D, dhe kërkon rinumërimin e tyre.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se Lirije Kajtazi, kandidate për deputete nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, kërkon rinumërim të votave në vendvotimet 2050A/02D, 2014A/02D, 2002A/03R, 0401D/17R, 0443D/01D.

PZAP, pas shqyrtimit të apelit Anr.764/2021, erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga Lirije Kajtazi, kandidate për deputete nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e pretenduara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë vetëm pretendime të saj, kjo rrjedhimisht sepse pritjet e ankueses për të marrë sa më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka edhe mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankueses nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Lirije Kajtazi, kandidate për deputete nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Anr. 764/2021 më datën 06.03.2021**

**Kryesuesja e Panelit**  
**Kymete Kicaj**



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.